

RIINTEGRIMI I TË KTHYERVE NË SHËRBIMIN SHËNDETËSOR

Je i kthyer nga një vend i Bashkimit Evropian?

Vuan nga sëmundje kronike dhe ke nevojë për
shërbim shëndetësor?

Ndiq hapat për të përfituar nga shërbimi shëndetësor publik



Zgjidh mjekun e familjes

- Shërbimi i mjekut të familjes përbën portën e sistemit shëndetësor
 - Shërbimet e ofruara nga mjeku i familjes janë falas
- Regjistrimi tek mjeku i familjes mund të bëhet duke u paraqitur në qendrën shëndetësore pranë vendbanimit tuaj, ose në platformën **e-Albania**
- Mjeku i familjes do të bëjë pajisjen me kartelën personale të qytetarit, dhe do të kryejë regjistrimin e tij në regjistrin themeltar të banorëve të cilët i mbulon me shërbim shëndetësor.



Ndiq sistemin e referimit për shërbim më të kualifikuar

- Mjeku i familjes referon pacientin tek mjeku specialist në poliklinikë
- Mjeku specialist i poliklinikës rekomandon pacientin në spitalin e rrethit;
- Mjeku në spitalin e rrethit, rekomandon pacientin në spitalin rajonal;
- Mjeku i spitalit rajonal rekomandon pacientin në Spitalin Universitar në Tiranë.

Kujdesi shëndetësor
nuk është privilegj

ËSHTË NJË E DREJTË



Regjistrohuni online tek mjeku i familjes!

Ndiq hapat:

- Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania;
- Zgjidh shërbimin "Regjistrim i individit pranë mjekut të familjes";
- Kliko butonin "Përdor";
- Plotëso të dhënat e kërkuara në formularin elektronik;
- Përzgjidh mjekun pranë të cilit kërko të regjistrohesh;
- Kliko butonin "Dërgo" në fund të formularit;

- Kërkesa i dërgohet për shqyrtim mjekut që keni përzgjedhur për regjistrim;
- Me anë të numrit të gjurmimit me cilin pajiseni pas aplikimit, mund të gjurmoni në çdo kohë statusin e aplikimit, ku do të informoheni nëse aplikimi juaj është në proces, aprovuar apo refuzuar me arsyen përkatëse;
- Tek llogaria juaj tek e-Albania (në adresën tuaj) ju vjen njoftimi me SMS, me email dhe tek "Mesazhet e Mia" në rubrikën "Hapësira lme" në portalin e-Albania për aprovimin apo refuzimin e kërkesës suaj;
- Në rast se kërkesa juaj do të aprovohet, ju do të jeni pjesë e listës së individëve që trajtohen me shërbim shëndetësor nga mjeku që ju keni përzgjedhur;
- Në rastet kur kërkesa juaj për regjistrim pranë mjekut të familjes është refuzuar, ju do të njiheni me arsyen e refuzimit dhe me pas mund të kryeni sërish aplikimin për t'u regjistruar pranë një mjeku tjetër familjeje.

SHËRBIMET SHËNDETËSORE QË OFROHEN FALAS

Të gjithë shtetasit shqiptarë në Republikën e Shqipërisë përfitojnë falas shërbimet shëndetësore bazë që ofrohen në qendrat shëndetësore / tek mjeku i familjes.

Kujdesi në rastet e urgjencës;
Kujdesi shëndetësor për fëmijët;
Kujdesi shëndetësor për të rriturit;
Kujdesi shëndetësor për gratë dhe shëndeti riprodhues;
Kujdesi shëndetësor për të moshuarit;
Kujdesi shëndetësor mendor;
Promocioni dhe edukimi shëndetësor.

Përfshihen nga pagesat e drejtpërdrejta për shërbime shëndetësore:

- Fëmijët 0-18 vjeç;
- Invalidët e plotë, përfshirë edhe invalidët paraplegjikë, tetraplegjikë dhe të verbrit e plotë;
- Invalidët e luftës;
- Veteranët;
- Personat që gëzojnë statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë;
- Jetimët;
- Personat që përfitojnë pagesën për aftësinë e kufizuar.

Përfitojnë falas alternativat e para të barnave të listës së barnave të rimbursueshme:

- Pensionistët;
- Personat e paraburgosur dhe të dënuarit me burgim;
- Azilkërkuesit;
- Viktimat e trafikimit;
- Personat me sëmundje kronike.

Pacienti ka të drejta, njihuhet me to!

E drejta për:

Akses në shërbimin shëndetësor;

Besueshmëri dhe intimitet në Qendrën Shëndetësore;

Informim;

Referim për vizitë më të kualifikuar, kur ka nevojë;

Zgjedhje të mjekut të familjes në KShP një herë në vit;

Kujdes të vazhdueshëm;

Pjesëmarrje në marrjen e vendimeve lidhur me shëndetin e tij;

Trajtim nga personel mjek dhe infermier i kualifikuar;

Refuzim të trajtimit mjekësor;

Informim mbi skemën e sigurimit të tij shëndetësor;

Ankimim për shërbimin shëndetësor, që i ofrohet.

SHËNDETI MBI TË GJITHA!